

ÇFARË ËSHTË MARKA TREGTARE ?

Marka tregtare është një shenjë dalluese, e cila identifikon mallra apo shërbime të ofruara nga një individ apo ndërmarrje e caktuar. Origjina e saj e ka zanafillën nga kohët e lashta, kur artizanët riprodhuan nënshkrimet e tyre ose “markat” në produktet e tyre artistike apo të përdorimit të përditshëm. Gjatë viteve, këto marka u zhvilluan për të arritur në sistemin e sotëm të regjistrimit e mbrojtjes.



ÇFARË SJELL MBROJTJA E MARKËS TREGTARE ?

* Marka e regjistruar tregtare i ofron mbrojtje ligjore pronarit të saj, duke i siguruar të drejtën ekskluzive për ta përdorur atë, me qëllim identifikimin e mallrave ose shërbimeve apo të autorizojë dikë tjetër për ta përdorur atë në këmbim të pagesës.

*Mbrojtja zgjat për një periudhë 10-vjeçare, por ajo mund të ripërtërihet për një kohë të pakufizuar përtej këtij afati, nëse paguhen tarifatat e ripërtëritjes.

* Mbrojtja e markës tregtare zbatohet nga gjykata, e cila ka kompetencën për të bllokuar shkeljet e markave tregtare.

* Mbrojtja e markave tregtare pengon, në të njëjtën kohë, përpjekjet e konkurrentëve të pandershëm, si falsifikuesit, për të përdorur shenja dalluese të ngjashme për tregtimin e produkteve apo shërbimeve më të dobëta.

CILAT MARKA TREGTARE MUND TË REGJISTROHEN ?

* Mundësitë janë thuajse të pakufizuara. Markat mund të jenë kombinim fjalësh, shkronjash dhe numrash. Ato mund të përbëhen nga skica, simbole, shenja tredimensionale, si forma dhe ambalazhimi i mallrave, shenja dëgjimore, si tingujt muzikorë ose vokalë, aromat ose ngjyrat që përdoren si tipare dalluese.

Përveç markave që identifikojnë burimin tregtar të mallrave dhe shërbimeve, ekzistojnë edhe kategori të tjera të markave tregtare:

* Markat kolektive



* Marka çertifikuese përdoren si tregues i cilësisë, prejardhjes, metodës së prodhimit apo karakteristikave tjera të përbashkëta të mallrave apo shërbimeve.



ÇFARË TË DREJTASH KA PRONARI I NJË MARKË TREGTARE?

Pronari i një marke tregtare ka të drejtën të vendosë se kush mund ta përdorë ose jo markën tregtare. Pronari i markës tregtare mund t'iu japë autorizim apo licencë palëve të tjera për përdorimin e markës, në bazë të kushteve për të cilat është rënë dakord në mënyrë të ndërsjellë. Pronari mund t'ia shesë, gjithashtu, të drejtën dikujt tjetër, i cili, më pas, bëhet pronari i ri i kësaj marke tregtare. Nëse regjistrimi i markës nuk ripërtërihet, mbrojtja e markës tregtare mbaron me përfundimin e afatit të saj dhe pronari nuk zotëron më të drejta ekskluzive mbi markën.



SI MERRET NJË MARKË TREGTARE?

Duhet ndërmarrë hapat procedural në vijim :
1) Paraqitja e aplikimit për regjistrim të markës tregtare, që përmban:

*Formularin e aplikimit për regjistrimin e markës,

* Dukjen e shenjës,

* Listën e mallrave dhe shërbimeve ku do të zbatohet shenja, duke treguar kategoritë e klasifikimit të Nisës,

*Informatat e aplikuesit,

* Dëshminë e pagesës së tarifës,

* Autorizimin (nëse paraqitësi i aplikacionit nuk e ka selinë në vend),

* Deklaratën e prioritetit, nëse ka një aplikim të huaj të mëparshëm,

- 2) Ekzaminimi,
- 3) Publikimi i aplikimit për markë tregtare,
- 4) Kundërshtimi, brenda 3 muajve,
- 5) Regjistrimi ose refuzimi i markës tregtare.



KUSHTET PËR REGJISTRIMIN E MARKËS TREGTARE?

Shenja duhet të përmbushë disa kushte, me qëllim që të gëzojë mbrojtjen si markë tregtare. Ajo duhet të jetë e dallueshme, në mënyrë që konsumatorët të mund ta shquajnë si shenjë identifikuese të një produkti të caktuar, si edhe nga markat e tjera identifikuese të produkteve. Ajo nuk duhet të keqinformojë, të mashtrtojë apo të vejë në lajthitje konsumatorët dhe as të shkelë rendin e moralin publik. Së fundi, të drejtat për të cilat aplikohet nuk mund të jenë të njëjta apo të ngjashme me të drejtat që i janë dhënë tashmë një pronari tjetër marke.

CILI INSTITUCION ËSHTË PËRGJEGJËS PËR REGJISTRIMIN E MARKËS TREGTARE?

* Në Kosovë markat tregtare regjistrohen nga Agjencia e Pronësisë Industriale (API) pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë .

CILA ËSHTË BAZA LIGJORE?

- * Ligji Nr. 04 L-026 për Markat Tregtare
- * Ligji Nr. 05 L-040 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04 L-026 për Marka Tregtare
- * Udhëzimi Administrativ Nr. 14/2016 për Regjistrimin e Markës Tregtare
- * Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2016 për Tarifat Administrative për Objektet e Pronësisë Industriale

SA KUSHTON NJË MARKË TREGTARE?

Kostoja e marrjes së një marke tregtare:
* tarifat zyrtare; shih Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2016 për Tarifat Administrative për Objektet e Pronësisë Industriale

FAQE INTERNETI

- www.mti.rks-gov.net
- www.kipa.rks-gov.net

KONTAKT

Agjencioni për Pronësi Industriale
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Rr. "Muharrem Fejza", p.n, Lagjja e Spitalit,
10000- Prishtinë, Kosovë
Telefon: +381 38 200 36554

ÇFARË ËSHTË MARKA TREGTARE?

Çfarë duhet të dini ...



Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Agjencia e Pronësisë Industriale
Rr. Muharrem Fejza, 10000, Prishtinë
+381 38 200 36 554